



Pranuar / Dosturuar Punehop/Predata Received/Deliverty	10.02.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	SKDMSTICK	673/2022	115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.05/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.05/2022 të datës 06.01.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë Komunën e Kamenicës, kundër Vendimit me numër 02NR.38846 të datës 28.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike "Transferim i përhershëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e nisur sipas ankesës A.nr.05/2022 të datës 06.01.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas Kontratës mbi marrëdhënies e punës së datës 14.02.2019 ka qenë e punësuar në pozitën "Udhëheqëse e Departamentit të Administratës" në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Kamenicës. Më datë 26.03.2019 Ministria e Administratës Publike përmes ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Kamenicës që "...në kategorinë e nëpunësve civile hyjnë të gjithë nëpunësit që punojnë në administratën e QKMF-së tuaj siç është rasti me sekretarin". Kryetari i Komunës së Kamenicës më datë 01.04.2019 ka njoftuar U.D. Drejtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare që në pajtim me opinionin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil të Ministrisë së Administratës Publike, ankuesja nuk ka të drejtë të jete edhe pjesë e administratës së QKMF-së dhe Këshilltare në Kuvendin Komunal të Kamenicës, duke kërkuar që të kërkoj nga ajo të definoj se cilën pozitë dëshiron me mbajt, po ashtu ka kërkuar që të fillohet me harmonizimin e kontratave për të gjithë punonjësit e administratës si nëpunës civil.

Më datë 06.08.2019 Komuna e Kamenicës ankueses i ka lëshuar Akt Emërimin për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë" të cilin e ka nënshkruar edhe ankuesja.

Ankuesja më datë 19.08.2019 ka parashtruar kërkesë për pezullim të dakorduar të vendit të punës, ndërsa në bazë të Vendimit të datës 28.08.2019 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës është bërë pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës së ankueses deri në përfundimin e mandatit të funksionarit të emëruar politik.

Ankuesja më datë 03.09.2019 kundër këtij akt emërimi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kamenicës, më datë 01.10.2019 ka nxjerr vendim me të cilin hedhet poshtë për jo kompetencë për të shqyrtuar ankesën e ankueses.

Ankuesja më datë 04.11.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 5162/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.11.2019 ka njoftuar ankuesen që ankesa e saj nuk mund të shqyrtohet për shkak që Këshilli është jofunksional duke e udhëzuar që për procedurat e tjera mund të drejtohet gjykatës në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Pasi që ankuesja ka filluar konfliktin administrativ, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 23.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2712/2019, me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të vendos për ankesën e datës 04.11.2019 të ankueses, mirëpo ankuesja kundër Aktgjykimit A.nr.2712/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar ankesë më datë 17 dhjetor 2021 në Gjykatën e Apelit të Kosovës, rrjedhimisht ka pezulluar efektet e këtij aktgjykimi.

Pas mbarimit të mandatit si këshilltare në Kuvendin Komunal të Kamenicës, ankuesja më datë 06.12.2021 ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Kamenicës me të cilin ka kërkuar që të kthehet në vendin e punës Udhëheqëse e Departamentit të Administratës në QKMF në Kamenicë.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, më datë 28.12.2021 ka nxjerr Vendim me numër 02Nr.38846 me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesën e ankueses duke e transferuar ankuesen në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale", me arsyetim që pozita të cilën e keni mbajtur është rekrutuar me konkurs dhe konformë legjislacionit në fuqi të shërbimit civil.

Ankuesja kundër Vendimit me numër 02Nr.38846 të datës 28.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, fizikisht më datë 06.01.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Port:13/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores

Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.01.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Kamenicës. Më datë 124.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Kamenicës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:13/2022 e datës 06.01.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 02Nr.38846 të datës 28.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Listën e pagave korrik 2019 për shërbimet e shëndetësisë primare-Kamenicë; Emailin e datës 01.04.2019 nga Q.Kastrati për Emailin e datës 26.03.2019 nga për Akt Emërimit e datës 06.08.2019 në emër të ankueses; Njoftimin e datës 07.05.2019; Kërkesën e datës 23.10.2020 nga ankuesja; Përgjigjen e datës 17.11.2020 për ankuesen nga Drejtori i QKMF-Kamenicë; Vendimin A.nr.428/2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 22.03.2021 nga për ankuesen; Emailin e datës 22.03.2021 nga ankuesja për Kërkesë për pezullim të dakorduar të vendit të punës e datës 19.08.2019 nga ankuesja; Vendimin e datës 28.08.2019 për pezullim të përkohshëm të marrëdhënies së punës; Konkursin e Brendshëm (Avancim) i datës 14.02.2020 për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë; Kontratën e Marrëdhënies së punës e datës 14.02.2019 në emër të ankueses; Emailin e datës 26.12.2021 nga Emailin e datës 21.12.2021 nga për Emailin e datës 17.04.2019 nga ankuesja për Emailin e datës 16.04.2019 nga ankuesja për Kërkesën e datës 06.12.2021 nga ankuesja për Kryetarin e Komunës së Kamenicës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.01.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 24.01.2022; Aktgjykimin A.nr.2712/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 09.03.2020; Vendim i datës 25.06.2019 nga Inspektorati i Punës; Vendimin e datës 15.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Vendimin e datës 08.05.2019 të Inspektoratit të Punës; Vërejtje e datës 05.08.2019 nga ankuesja për Menaxherin e Personelit; Ankesën e ankueses për Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit A.nr.2712/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore që ankesa e ankueses të **pezullohet, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.01.2022 kundër Vendimit me numër 02Nr.38846 të datës 28.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës me të cilin është transferuar në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale", pretendon që duhet të kthehet në pozitën Udhëheqëse e Departamentit të Administratës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Kamenicës sepse në këtë rast është dëmtuar edhe në pagë për dy grada dhe duke ma mohuar statusin si nëpunëse e shërbimit publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me ndryshimin e pozitës nga pozita Udhëheqëse e Departamenti të Administratës në QKMF sipas Kontratës së Marrëdhënies së punës e datës 14.02.2019 në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë sipas Akt Emërimit të datës 06.08.2019, ankueses përveç që i është ndryshuar pozita po ashtu i është ndryshuar edhe paga.

Meqenëse ankuesja kundër këtij ndryshimi respektivisht kundër Akt Emërimit të datës 06.08.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe e njëjta ankesë nuk është shqyrtuar edhe pse Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykim A.nr.2712/2019 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të shqyrtoj ankesën e datës 04.11.2019 të ankueses, sepse ankuesja kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana dhe duke e vlerësuar që ankuesja në ankesën e datës 04.11.2019 dhe 06.01.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pretendimet që të kthehet në vendin e punës që e ka mbajtur me Kontratën e Marrëdhënies së punës të datës 14.02.2019, atëherë meqenëse nuk është vendosur përfundimisht lidhur me Akt Emërimit të datës 06.08.2019 dhe lënda për të njëjtën çështje është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, atëherë ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që shqyrtimi i ankesës së datës 06.01.2022 të pezullohet deri në vendosjen përfundimtare nga Gjykata e Apelit të Kosovës, pasi që objekti i shqyrtimit të dy ankesave është i njëjtë dhe shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore, kjo ndërlidhet duke marrë për bazë dispozitat e nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, pas vendosjes së rastit nga Gjykata e Apelit të Kosovës, sipas ankesës, ndërlidhur me Akt Emërimit të datës 06.08.2019, do të vendos edhe për ankesën e datës 06.01.2022.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nënin 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.05/2022, datë 10.02.2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

